



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3716/Prot.

Elbasan, më 18.7.2023

Lënda: Mbi ankimimin e znj. Aurora Shpataj.

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Rruga "Abdi Toptani", Nd.5, Tiranë

ZNJ. AURORA SHPATAJ

Rruga "Pjetër Budi", 69, Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj me nr.1213/1prot. datë 12.07.2023 "Mbi ankimimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare" nga znj. Aurora Shpataj, ju bëjmë me dije se ne vlerësojmë të drejtën tuaj dhe të zonjës në fjalë, për të marrë informacionin e nevojshëm dhe punojmë vazhdimisht për të ofruar transparencë dhe përgjegjësi për të gjitha shërbimet tona.

Në lidhje me informacionin që kërkohet të vihet në dispozicion, znj. Shpataj duhet t'i drejtohet Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Elbasan si institucioni përgjegjës për të dhënat statistikore mbi numrin e nxënësve të arsimit parauniversitar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm në Bashkinë Elbasan.

Përsa i përket numrit të shkollave në bashkinë Elbasan, ju bëjmë me dije se Bashkia Elbasan aktualisht ka në juridiksionin e saj rreth 104 objekte arsimore të shpërndara në 6 Rajone dhe 12 Njësi Administrative, nga të cilat 61 janë shkolla qendër dhe 43 janë shkolla vartëse.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

NËNKRYETARI

Aulona Bylykbashi



